

Në bazë të nenit 3 paragrafi 1 alineja 20 dhe neni 13 nga Ligji për Qendrën Shtetërore të Provimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 142/08, 148/09, 41/14, 55/16, 142/16 dhe 64/18) lidhur me nenin 10 dhe 13 të Rregullores mbi mënyrën, procedurën dhe kriteret për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve dhe të caktimit të lartësisë së kompensimeve autoriale dhe kompensimeve për shërbime të tjera të Qendrës Shtetërore të Provimeve nr. 01-292/3 nga 31.05.2018, Qendra Shtetërore e Provimeve, publikon:

**KONKURS PUBLIK**  
***për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – vlerësues***

Për shkak të realizimit të menjëhershëm dhe urgjent të procesit të vlerësimit të materialit testues nga Matura Shtetërore në afatet e parapara, Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup shpall konkurs publik për zgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm – ***vlerësues të testeve nga pjesa eksterne e maturës shtetërore në vitin shkollor 2018/2019***, për lëndët:

- ***Gjuhë maqedonase dhe letërsi;***
- ***Gjuhë shqipe dhe letërsi;***
- ***Gjuhë turke dhe letërsi;***
- ***Gjuhë angleze;***
- ***Gjuhë frënge;***
- ***Gjuhë gjermane;***
- ***Gjuhë ruse;***
- ***Matematikë (në gjuhën mësimore maqedonase);***
- ***Matematikë (në gjuhën mësimore shqipe);***
- ***Matematikë (në gjuhën mësimore turke);***
- ***Fizikë (në gjuhën mësimore maqedonase);***
- ***Fizikë (në gjuhën mësimore shqipe);***
- ***Fizikë (në gjuhën mësimore turke);***
- ***Kimi (në gjuhën mësimore maqedonase);***
- ***Kimi (në gjuhën mësimore shqipe);***
- ***Kimi (në gjuhën mësimore turke);***
- ***Biologji (në gjuhën mësimore maqedonase);***
- ***Biologji (në gjuhën mësimore shqipe);***
- ***Biologji (në gjuhën mësimore turke);***
- ***Estetikë / Filozofi (në gjuhën mësimore maqedonase);***
- ***Estetikë / Filozofi (në gjuhën mësimore shqipe);***
- ***Filozofi (në gjuhën mësimore turke);***
- ***Biznes (në gjuhën mësimore maqedonase);***
- ***Biznes (në gjuhën mësimore shqipe);***
- ***Biznes (në gjuhën mësimore turke);***
- ***Histori (në gjuhën mësimore maqedonase);***
- ***Histori (në gjuhën mësimore shqipe);***
- ***Histori (në gjuhën mësimore turke);***
- ***Sociologji (në gjuhën mësimore maqedonase);***
- ***Sociologji (në gjuhën mësimore shqipe);***
- ***Sociologji (në gjuhën mësimore turke).***

Vlerësimi i testeve do të bëhet në Shkup, në periudhën nga **08.06.2019 deri më 25.06.2019**.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të kenë arsimin e lartë adekuat;
- të kenë së paku tre vjet përvojë punë në mësimdhënie;
- të jenë në procesin arsimor në shkollë të mesme në lëndën përkatëse.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriteret:

- flet aplikim të plotësuar;
- kopje të certifikatës / diplomës për arsimim të lartë adekuat;
- vërtetim në origjinal që ka realizuar mësimdhënie në lëndën përkatëse, në shkollë të mesme, me numrin e viteve të përvojës së punës në veprimtarinë edukative arsimore (jo më të vjetër se tre muaj).

Flet aplikimi mund të shkarkohet nga ueb-faqja [www.matura.gov.mk](http://www.matura.gov.mk)

Flet aplikimet me dokumentacionin e paplotë dhe jo valid dhe flet aplikimet e dorëzuara me vonesë nuk do të jenë lëndë shqyrtimi.

Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e mësipërme do të ftohen për trajnim dhe do të testohen, më pas do të bëhet zgjedhja përfundimtare.

Kandidatët të cilët nuk do të marrin pjesë në trajnim, nuk do të merren parasysh në procedurën e mëtutjeshme.

Konkursi është i hapur deri më **19.04.2019**.

Flet aplikimi me dokumentacionin e duhur dorëzohet me anë të dërgesës së rekomanduar postare, në adresën e mëposhtme: *Qendra Shtetërore e Provimeve – Shkup, rr. "Vasil Gjorgov" p.n. 1000 Shkup*, me shenjën **për konkursin publik dhe lëndën për të cilën po paraqiteni**.

**QENDRA SHTETËRORE E PROVIMEVE**